



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

1134/2

UDHËZIM PLOTËSUES

NR. 2/1 DATË 11.7.2025

“PËR

NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 24.01.2025, TË MINISTRIT TË
FINANCËVE “PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 21 të ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, pas pikës 17, shtohet pika 17/1 me përmbajtje si më poshtë:

“17/1. Fondi prej 200 milionë lekë, në financimin e huaj të parashikuar në programin buxhetor “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” në ministrinë përgjegjëse për financat, përdoret si tavan për financimin e projekteve të investimeve publike me financim të huaj në formën e granteve të huaja sipas procedurave të shpërndarjes të përcaktuara në Aneksin C bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë më 31 Dhjetor 2025.

MINISTRI



ANEKSI C

“Mbi përdorimin e fondit për grantet e huaja që përdoren nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në rastet kur ato nuk janë parashikuar në buxhetin fillesar”.

- Titullari i Njesisë së Qeverisjes së Përgjithshme analizon dhe vlerëson nevojën për financim për projekte të investimeve publike me financim të huaj në formën e granteve të huaja në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 887, datë 27.12.2022 *“Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”*, i ndryshuar.
- Kërkesa për miratimin e projektit me financim të huaj në formën e grantit përfshin:
 - Analizë dhe argumentim të pamundësisë për financimin nga buxheti i alokuar me ligjin vjetor të buxhetit ose nga burimet e veta;
 - Formularin e Konceptimit të Projektit të Investimit;
 - Marrëveshjen e grantit të nënshkruar me donatorët përkatës.
- Afati i aplikimit për të përfituar nga fondi për grante të huaja të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në rastet kur ato nuk janë parashikuar në buxhetin fillesar, është data 15 Nëntor.
- Ministri përgjegjës për financat, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, shqyrton kërkesën e Njesisë së Qeverisjes së Përgjithshme dhe miraton ose jo përdorimin e fondit për projektet me financim të huaj grant të alokuar në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme” të Ministrisë së Financave.
- Alokimi i fondeve për projektet me financim të huaj grant për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme i nënshtrohet të gjitha rregullave dhe procedurave të ligjit nr.9936/2008, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Institucionet përfituese të këtij fondi raportojnë për përdorimin e tij në ministrinë përgjegjëse për financat, si pjesë e raportimeve zyrtare për monitorimin e buxhetit vjetor si dhe të monitorimit të projekteve të investimeve publike.